03/02 07 499/24 22.03.24

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 11 paragrafi 4 të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 22.03.2024, nxjerrë këtë:

VENDIM

I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-105/24, për zyrtarin z. Sadik Bekteshi, Profesor i Fakultetit të Shkencave Matematiko Natyrore, Departamenti i Fizikës, në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Arsyetim

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin z. Sadik Bekteshi, është trajtuar sipas procedurës së paparë me Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas kërkesës së pranuar nga jashtë - raportuesi i rastit (DPKI-105/24), me të cilën është kërkuar inicimi i procedurës për konflikt të interesit ndaj z. Sadik Bekteshi dhe Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (në vijim: UPHP), pasi që, siç theksohet në kërkesë, *z. Sadik Bekteshi ka qenë Kryetar i Komisionit Vlerësues për pozitën nr. 10, në Fakultetin e Edukimit* (në vijim: FE) *të UPHP-së, sipas Konkursit nr. 1/131, i datës 31.05.2023, i cili komision nuk e ka vlerësuar L. K. si kandidat që i plotëson kushtet për emërim si profesor asistent - mësimdhënës për një grup të lëndëve, në mesin e tyre edhe lënda 'Mësimdhënia dhe të nxënit e Fizikës I (O)'.*

Ndër të tjera, parashtruesi i kërkesës ka theksuar se: *"[...] Sipas orarit mësimor për semestrin e dimrit në Fakultetin e Edukimit, për lëndën 'Mësimdhënia dhe të nxënit e Fizikës I', lëndë e pozitës 10 të Konkursit, si profesor figuron Prof. Dr. Sadik Bekteshi i cili ishte i angazhuar në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Vlerësues për lëndën e Fizikës. [...] marrë parasysh se një profesor i cili është ngarkuar me përzgjedhjen dhe vlerësimin e kandidatëve që aplikojnë për pozitat dhe lëndët përkatëse sipas konkursit, NUK e ka rekomanduar përzgjedhjen e ndonjë kandidati që ka aplikuar në mënyrë të rregullt në konkurs, me qëllim që pozitën e lirë të mësimdhënësit për lëndët përkatëse, ta ruaj për vete! [...] Këtu ka shkelje flagrante të dispozitave të Ligjit per Parandalimin e Konfliktit të Interesit, si nga Prof. Dr. Sadik Bekteshi,*

ashtu edhe nga menaxhmenti i Fakultetit të Edukimit dhe Senati i Universitetit të Prishtinës, që e bënë të domosdoshëm inicimin e procedurës për konflikt te interest pranë Agjencisë kundër Korrupsionit, fillimisht ndaj Prof. Dr. Sadik Bekteshi dhe ndaj secilit person tjetër përgjegjës veç e veç [...]".

Tutje parashtruesi i kërkesës, lidhur me situatën si më lartë, i është referuar shkeljes së nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të LPKI-së. Si dhe ka parashtruar kërkesën konkrete me të cilën kërkon nga Agjencia që pas shqyrtimit të kësaj kërkese dhe të provave të bashkëlidhura, të ndërmarrë veprimet si në vijim:

I. TË INICOJ Procedurën për Vërtetimin e Ekzistimit të Konfliktit të Interesit ndaj Prof. Dr. Sadik Bekteshi;

II. TË INICOJ Procedurën për Vërtetimin e Ekzistimit të Konfliktit të Interesit ndaj çdo personi tjetër përgjegjës brenda Universitetit të Prishtinës bazuar në rezultatet e verifikimit dhe hetimit administrativ të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërive;

III. TË KONSTATOJ se ushtrimi i detyrës së profesorit për lëndën "Mësimdhënia dhe të nxënit e fizikës I" në Fakultetin e Edukimit nga Prof. Dr. Sadik Bekteshi është në papajtueshmëri me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;

IV. TË DETYROJ Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" që të ndërpres marrëdhënien e punës me Prof. Dr. Sadik Bekteshi në cilësinë e tij si profesor për lëndën "Mësimdhënia dhe të nxënit e fizikës I" në Fakultetin e Edukimit;

V. TË DETYROJ Prof. Dr. Sadik Bekteshi të heqë dorë nga pozita e tij si profesor për lëndën "Mësimdhënia dhe të nxënit e fizikës I" në Fakultetin e Edukimit;

VI. TË INICOJ procedurën administrative për revokimin ose shfuqizimin e të gjitha akteve nga ana e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" që i ka lëshuar ato në konflikt interesi, respektivisht aktet (I) Vendimi me nr. prot. 4/210 të dr. 20.12.2023 i Senatit të Universitetit të Prishtinës dhe (i) Njoftimi 2/328 i du. 12.10.2023 i Senatit të Universitetit të Prishtinës dhe (iii) Raporti i Komisionit Vlerësues 1889 i dt. 04.07.2023 për palën L. K., i publikuar në Buletinin nr. 8 i dt. 11.07.2023.

VII. TË INICOJ procedurën gjyqësore për anulimin e akteve vijuese (I) Vendimi me nr. prot. 4/210 të dt. 20.12.2023 i Senatit të Universitetit të Prishtinës dhe (ii) Njoftimi 2/328 i dt. 12.10.2023 i Senatit të Universitetit të Prishtinës dhe (ii) Raporti i Komisionit Vlerësues 1889 i dt. 04.07.2023 për palën L. K., i publikuar në Buletinin nr. 8 i dt. 11.07.2023 dhe për detyrimin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për shlyerjen e pasojave materiale dhe financiare të akteve të marra në kushtet e konfliktit të interesit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së, përkatësisht vetëm pretendimet që lidhen me dyshimin për konflikt të interesit, përkitazi me pjesmarrjen e tij në vlerësimin e kandidatëve (vendimmarrjen) për pozitën nr. 10, në FE të UPHP-së, sipas Konkursit nr. 1/131, i datës 31.05.2023, pjesë e së cilës pozitë ka qenë edhe lënda 'Mësimdhënia dhe të nxënit e Fizikës I', si dhe pretendimet që lidhen me dyshimet përkitazi me marrjen dhe mbajtjen e lëndës në fjalë, nga z. Sadik Bekteshi.

Agjencia nuk ka trajtuar kërkesat dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e dispozitave të statutit dhe akteve tjera normative të UPHP-së, të cilat lidhen me rregullsinë dhe/apo ligjshmërinë e procesit për pozitën nr. 10 në FE të UPHP-së, sipas konkursit nr. 1/131/, i datës 31.05.2023, siç janë: *shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës në Vendimin e Senatit të UP-së me nr. prot. 4/210 të dt. 20.12.2023; shkeljet esenciale të procedurës dhe konstatimi i gabuar i gjendjes faktike nga Senati dhe nga komisioni vlerësues; shkeljet e procedurës që ndërlidhën me përbërjen e komisionit vlerësues; standardet e dyfishta gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve - trajtimi i pabarabartë i kandidatëve të barabartë; në veprimet e organeve vendimmarrëse formësohen elementet e veprës penale nga neni 190 dhe neni 414 i Kodit Penal; shkeljet tjera të procedurës të cilat kanë pamundësuar ushtrimin efektiv të së drejtës kushtetuese të ankesës dhe shkeljet e së drejtës materiale, etj.*, pasi që këto kërkesa dhe pretendime janë jashtë sferës së konfliktit të interesit dhe si të tilla nuk janë në mandat të Agjencisë.

Kësisoj, Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-06/02-212/24, e ka njoftuar zyrtarin z. Sadik Bekteshi, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas është organizuar dhe mbajtur një takim në Agjenci, me ç'rast z. Sadik Bekteshi është njoftuar lidhur me pretendimet e ngritura dhe faktet për rastin e saj.

Zyrtari në fjalë, ka paraqitur qëndrimet dhe argumentet e tij karshi pretendimeve të ngritura, duke paraqitur edhe prova të shkruara përkitazi me deklarimet dhe sqarimet e tij. I njëjti, ndër të tjera ka theksuar se, është profesor i rregullt në Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore (në vijim: FSHMN), Departamenti i Fizikës, në UPHP, ndërsa në FE të këtij Universiteti, është vetëm i angazhuar për mbajtjen e disa lëndëve. Sipas sqarimeve të tij, ky angazhim është bërë në bazë të kërkesës së Dekanit të FE dhe propozimit të Dekanit të FSHMN-së. Ai ka pranuar se ka qenë kryetar i komisionit vlerësues për pozitën nr. 10, në FE të UPHP-së, sipas Konkursit nr. 1/131, i datës 31.05.2023, por ka theksuar se vlerësimi i komisionit i cili ka qenë unanim për këtë pikë të konkursit, është vetëm i karakterit rekomandues, sepse procedura ka vazhduar tutje nëpër organet përkatëse brenda njësisë akademike dhe deri në Senat i cili ka marrë vendimin final.

Gjithashtu, z. Sadik Bekteshi ka sqaruar se për vitit akademik 2023/24 (pas pjesmarrjes së tij në komisionin vlerësues për pozitën nr. 10 në FE), ka mbajtur vetëm dy lëndë në këtë fakultet, dhe atë lëndën Puna laboratorike dhe eksperimentale në të nxënit e fizikës - semestri dimëror dhe lëndën Mësimdhënia dhe të nxënit e fizikës II - semestri veror. Për më tepër, zyrtari në fjalë ka dorëzuar në Agjenci komunikimin ndërmjet dekanëve të njësive akademike si më lartë dhe një vërtetim të lëshuar nga Dekani i FE.

Përveç kësaj, më qëllim të sqarimit të situatës gjithnjë në kontest të zbatimit të dispozitave të LPKI-së dhe konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-06-433/24, ka kërkuar nga Dekani i FE të UPHP-së informata, sqarime dhe dokumentacionin relevant lidhur me angazhimin e z. Sadik Bekteshi në FE.

Dekani i FE, duke vepruar sipas kërkesës si më lartë, ka dërguar në Agjenci informatat përmes shkresës zyrtare DPKI-06/02-433-1/24, me të cilën ka sqaruar se:

> *"[...] Ky dokument është lëshuar, [...] për të konfirmuar se Prof. Dr. Sadik Bekteshi, staf i rregullt në FSHMN në Universitetin e Prishtinës ka qenë i angazhuar si mësimdhënës në*

vitin akademik 2023/2024 në Fakultetin e Edukimit në lëndët: Puna laboratorike dhe eksperimentale në të nxënit e fizikës - semestri dimëror dhe Mësimdhënia dhe të nxënit e fizikës II - semestri veror. [...] procedura e angazhimit të stafit nga fakulteti tjetër (pra nga FSHMN) ka shkuar përmes kërkesës që unë si dekan i kam dërguar dekanit të FSHMN-s dhe ai ka dhënë propozimet pas konsultimeve me departmanetin e fizikës atje. Në fillim FSHMN kishte propozuar Prof. Sadik Bekteshi për lëndë 'Mësimdhënia dhe të nxënit e fizikës I' por pas shpalljes së orarit, Fakulteti ka bërë ndryshim, me kërkesë të prof. Bekteshi, dhe në këtë lëndë e ka vendosur profesorin S. K. nga i njëjti fakultet, i cili e ka mbajtur lëndën në tërësi."

... si material plotesues në lidhje me çështjet e ngritura per raportet recensuese, përgjigjes si më lartë ia ka bashkangjitur edhe Rregulloren nr. prot. 886, e datës 27.04.2022.

Kësisoj, Agjencia pasi ka administruar si prova (vetëm provat që lidhen me pretendimet për konflikt të interesit) kërkesën e parashtruesit dhe dokumentacionin e bashkangjitur, të dhënat (informatat) nga burimet që janë publike, sqarimet e z. Sadik Bekteshi në takimin e mbajtur në Agjenci dhe dokumentet e dorëzuara nga zyrtari në fjalë, si dhe përgjigjen zyrtare të pranuar nga Dekani i Dekani i FE të UPHP-së, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Më datë 31.05.2023, UPHP ka publikuar Konkursin Nr. 1/331 për emërimin, riemerimin ose avancimin e personelit akademik në Fakultetet e Universitetit të Prishtinës. Sipas pikës XIII [Fakulteti i Edukimit], pozita nr. 10 e konkursit, është kërkuar një mësimdhënës për një grup të lëndëve, në mesin e tyre lënda 'Mësimdhënia dhe të nxënit e fizikës I'.

Kandidati L. K. ka aplikuar për pozitën nr. 10 të konkursit si më lartë për emërim për herë të parë në FE.

Komisioni Vlerësues për pozitën nr. 10 të konkursit është përbërë z. Sadik Bekteshi, i cili ka qenë kryetar i këtij komisioni dhe dy anëtarë tjerë.

Sipas Raportit të Komisionit Vlerësues si më lartë nr. prot. 04-1889, i datës 04.07.2023, për pozitën nr. 10 të konkursit në FE, komisioni në fjalë unanimisht ka vlerësuar se kandidati L. K. nuk ka përgatitje adekuate akademike [...] dhe ka propozuar që i njëjti të mos emërohet në pozitën të cilën ka aplikuar.

Më datë 11.07.2023, UPHP ka publikuar Buletinin nr. 8, në përmbajtjen e të cilit gjindet edhe Raporti i Komisionit Vlerësues nr. prot. 04-1889, për pozitën nr. 10 në FE.

Më pas, brenda mekanizmave dhe organeve të UPHP-së është zhvilluar një proces i vendimmarrjes, i cili ka rezultuar me vendimet e Senatit me të cilët konfirmohet se kandidati L. K. nuk është emëruar për pozitën nr. 10, por Agjencia nuk i ka administruar prova për vërtetimin e fakteve tjera lidhur me konkursin (përveç atyre të konstatuara më lartë), pasi që të njëjtat nuk i ka vlerësuar si relevante për konstatimin e gjendjes faktike që lidhet me pretendimet për konfliktin e interesit.

Nga komunikimet elektronike (e-mailet) ndërmjet Dekanëve të njësive akademike të cilat z. Sadik Bekteshi i ka dorëzuar në Agjenci, vërtetohet se Dekani i FE përmes e-mailit të datës 18.10.2023, i ka dërguar Dekanit të FSHMN-së kërkesë për mbulimin e orëve në programin e mësimdhenies së fizikës për disa lëndë të semestrit dimëror dhe veror, në mesin e të cilave edhe

lënda Mësimdhënia dhe të nxënit e fizikës I. Ndërsa, Dekani i FSHMN-së me e-mailin e datës 19.10.2023, ka propozuar z. Sadik Bekteshi dhe një profesor tjetër. Ky fakt, vërtetohet edhe nga përgjigja zyrtare e Dekanit të FE për Agjencinë.

Sipas një tabele me orarin e ligjëratave për vitin akademik 2023/24 në FE - Mësimdhënia e Fizikës, semestri I, të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës figuron se z. Sadik Bekteshi është bartës i lëndës Mësimdhënia dhe të nxënit e fizikës I.

Lidhur me faktin si më lartë, z. Sadik Bekteshi në takimin e mbajtur ka sqaruar se edhe pse në orar ka qenë e vendosur që lënda në fjalë mbahet nga ai, ka kërkuar nga Dekani që i njëjti të lirohet nga kjo lëndë, ashtu që këtë lëndë e ka mbajtur profesori tjetër i FSHMN-së i angazhuar në FE. Kjo vërtetohet edhe nga përgjigja zyrtare e Dekanit të FE të dërguar në Agjenci, me të cilën ka theksuar se: *"Në fillim FSHMN kishte propozuar Prof. Sadik Bekteshi për lëndë 'Mësimdhënia dhe të nxënit e fizikës I' por pas shpalljes së orarit, Fakulteti ka bërë ndryshim, me kërkesë të prof. Bekteshi, dhe në këtë lëndë e ka vendosur profesorin S. K. nga i njëjti fakultet, i cili e ka mbajtur lëndën në tërësi."*

Nga orari i provimeve, programi MA mësimdhënia lëndore, viti akademik 2023/24, i cili është publik në uebfaqen e FE[1], tek programi mësimdhënia e fizikës, figuron se bartës i provimeve për lëndën Mësimdhënia dhe të nxënit e fizikës I, është një profesor tjetër (S. K), e jo z. Sadik Bekteshi.

Me Vërtetimin Dekanit të FE i datës 21.02.2024, të cilin z. Sadik Bekteshi ka dorëzuar në Agjenci, konfirmohet se: *"[...] se Prof. Dr. Sadik Bekteshi, staf i rregullt në FSHMN në Universitetin e Prishtinës ka qenë i angazhuar si mësimdhënës në vitin akademik 2023/2024 në lëndët: Puna laboratorike dhe eksperimentale në të nxënit e fizikës - semestri dimëror dhe Mësimdhënia dhe të nxënit e fizikës II - semestri veror."* Ky fakt është konfirmuar edhe nga përgjigja zyrtare e Dekanit të FE për Agjencinë.

I. Në vështrim të pretendimeve dhe gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi, se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, për shkak se një situatë e tillë nuk bie ndesh me dispozitat e LPKI-së.

Së këndejmi, konflikti i interesit është i lidhur ngusht me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes privat* për vete apo për personat e afërm me të.

Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare"*, ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të*

[1] https://edukimi.uni-pr.edu/page.aspx?Id=1,51

lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje."

... lidhur me nenin 3 [Përkufizimet] paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: *"interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste"*, dhe nënparagrafi 1.12, me të cilin është e definuar nocioni i vendimmarrje si: *"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."*

Në kuptim dhe zbatim të dispozitave si më lartë, Agjencia ka konstatuar se pjesëmarrja e z. Sadik Bekteshi në cilësi të kryetarit të Komisionit Vlerësues për pozitën nr. 10 në FE të UPHP-së, sipas Konkursit nr. 1/131, i datës 31.05.2023, i cili komision nuk e ka vlerësuar L. K. si kandidat që i plotëson kushtet për emërim si profesor asistent - mësimdhënës për një grup të lëndëve, në mesin e tyre edhe lënda 'Mësimdhënia dhe të nxënit e Fizikës I (O)', si dhe më pas angazhimi i tij në Fakultetin e Edukimit, nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit sipas dispozitave të LPKI-së.

Kjo për faktin se, nuk është gjetur dhe vërtetuar që z. Sadik Bekteshi të ketë pasur çfarëdo përparsie - interes privat për 'vendimmarrjen' e tij (vlerësimin e kandidatit L. K.), përkatësisht nuk është gjetur dhe vërtetuar që vlerësimi i kandidatit L. K. (vendimmarrja) nga z. Sadik Bekteshi, të ketë ndërlidhje me angazhimin e mëpastajm të tij në FE, apo që kjo të jetë bërë me qëllim që z. Sadik Bekteshi, pozitën e lirë të mësimdhënësit për lëndën Mësimdhënia dhe të nxënit e fizikës I, ta ruaj për vete. Aq më tepër kur siç është konstatuar më lartë, z. Sadik Bekteshi nuk është angazhuar përkatësisht nuk është bartës i lëndës në fjalë.

Për më tepër, nuk janë vërtetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës se 'vendimmarrja' z. Sadik Bekteshi (vlerësimi i kandidatit L. K.) dhe angazhimi i tij në Fakultetin e Edukimit, të kenë qenë të ndërlidhura dhe/apo të kushtëzuara me njëra-tjetrën.

Me këtë rast, Agjencia ka pasur parasysh referimin e raportuesve të rastit në dispozitën e nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të LPKI-së, me të cilat është përcaktuar se: *"1. Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit i ndalohen këto veprime: [...] 1.3. të ndikojë në vendimin e ndonjë zyrtari apo organi për arsye të përfitimit të padrejtë për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik"*, por ka konstatuar se dispozitat në fjalë nuk vlejnë në këtë rast. Kjo për faktin se, nuk është gjetur dhe konstatuar (nuk ka pasur as pretendim konkret) që z. Sadik Bekteshi të ketë ndikuar tek ndonjë zyrtar apo organ dhe nga ky 'ndikim' të ketë pasur ndonjë përfitim të padrejtë për vete.

Andaj, në kontekst të shtatë (7) pikave të kërkesës së parashtruesit (I - VII), Agjencia në lidhje me pikën I. dhe III. të kërkesës, ka inicuar dhe zhvilluar procedurën e hetimit administrativ për dyshimet për konflikt të interesit ndaj z. Sadik Bekteshi, ku nga sa u tha më lartë, është konstatuar se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit. Ndërsa, në lidhje me pikën II. të kërkesës, Agjencia nuk ka inicuar procedurë ndaj ndonjë personi apo organi tjetër përgjegjës brenda FE apo UPHP-së,

pasi që bazuar në rezultatet e hetimit administrativ të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërive, nuk është gjetur se ka pasur ndonjë situatë të konfliktit të interesit në procesin e Konkursit nr. 1/131, i datës 31.05.2023, për pozitën nr. 10, në FE. Kështu që, pikat IV, V, VI dhe VII të kërkesës së parashtruesit janë pa objekt shqyrtimi dhe veprimi sipas tyre, për shkak se lidhur me pikat I, II dhe III, nuk është konstatuar ekzistimi i konfliktit të interesit.

Nga sa u tha më lartë, Agjencia vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: "*Të gjitha vendimet që i mxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmërtë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.*", si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: "*Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.*"

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit z. Sadik Bekteshi;
- Parashtruesit të kërkesës/përfaqësuesit;
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)